

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-300 Rapid Level

LLAÇ ÇIMENTOJE I VETËNIVELUESHËM, ME MPIKSJE TË SHPEJTË DHE I MODIFIKUAR ME POLIMERE PËR TRASHËSI APLIKIMI 1-10 MM. KATEGORIA C50-F10.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Llaç çimentoje i vetënivelueshëm me çlirime shumë të ulëta për pothuajse të gjitha llojet e nënshtresave të përshtatshme për shtrim. Për përdorim në mjedise të brendshme. Sikafloor®-300 Rapid Level ka tkurrje shumë të ulët, rezistencë shumë të lartë, tharje shumë të shpejtë dhe finiturë të lëmuar.

PËRDORIMET

Sikafloor®-300 Rapid Level është i përshtatshëm për mbushje, lëmim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara shtrimit të parketit, pllakave qeramike, dyshemeve prej rrëshire, mokatave dhe veshjeve elastike për dyshemetë (vinili, linoleum). Është i përshtatshëm për përdorim në mjedise të brendshme në zona rezidenciale dhe joindustriale si dhe gjithashtu zonat e sforcuara nga qarkullimi i pirunave.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm
- I përshtatshëm për aplikime në sistemet e ngrohjes nën dysheme
- Trashësi shtrese deri në 25 mm me agregate
- I përshtatshëm për ngarkesat e karrigeve me rrota të zyrave në trashësi shtrese më shumë se 1 mm sipas EN 12 529
- I pompueshëm
- Nivel i lartë fortësie dhe rezistence
- Trashësia e shtresës mund të shtohet pa humbje të rezistencës për trashësi të mëdha shtrese
- Për qarkullim pirunësh, trashësi shtrese të paktën 3 mm
- Porozitet i ulët i sipërfaqes

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EC 1 PLUS R: çlirime shumë të ulëta

MIRATIME / STANDARDE

Llaç çimentoje për nivelimin e dyshemeve CT-C50-F10 sipas EN 13813, deklaratë performance 115041502 dhe mbart markën CE.

Llaç çimentoje për nivelimin e dyshemeve sipas EN 13813, kategoria A1/A1fl sipas EN 13501-1, deklaratë performance 115041502, vlerësuar nga laboratorit i njoftuar 1378 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|--|
| Baza kimike | Me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere |
| Ambalazhi | 25 kg në thes letre |
| Paraqitja / Ngjyra | Gri |
| Jetëgjatësia | 6 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Thasët e hapur duhet të mbyllën menjëherë dhe të përdoren sa më shpejtë të jetë e mundur. Të mos ruhet nën +5°C. |

TË DHËNA TEKNIKE

| | | |
|---------------------------------------|--|--------------|
| Rezistenca ndaj ngjeshjes | ≥50 N/mm ² (28 ditë në 23 °C) | (EN 13892-2) |
| Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje | ≥10 N/mm ² (28 ditë në 23 °C) | (EN 13892-2) |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | | |
|--|--|---|
| Raporti i përzierjes | Sikafloor®-300 Rapid Level | ~6.0 l ujë për 25 kg Sikafloor®-300 Rapid Level |
| | Sikafloor®-300 Rapid Level me agregate | shtoni 16 kg ose 10 L rërë kuarci 0.1-3.0 mm për 25 kg Sikafloor®-300 Rapid Level (~65% për peshë) ~ 6.0 L ujë për 25 kg Sikafloor®-300 Rapid Level. |
| Konsumimi | ~ 1,5 kg/m ² /mm. | |
| Trashësia e shtresës | Sikafloor®-300 Rapid Level | 1-10 mm |
| | Sikafloor®-300 Rapid Level me agregate | 10-25mm |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min. / +30 °C max. | |
| Lagështia relative e ajrit | < 75% | |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min. / +30 °C max. | |
| Përgatitja e nënshtresës | Nënshtresa | Prajmer |
| | Nënshtresa me absorbueshmëri normale si betoni, llaçe çimentoje, llaçe çimentoje me mpiksje të shpejtë | Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer |
| | Nënshtresa gipsi ¹ | Sikafloor®-03 Primer or Sikafloor®-01 Primer (1:1) |
| | Nënshtresa joabsorbuese si ato të lyera me prajmer me mbetje adezivësh kundër ujit | Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer |
| | Dru i përpunuar dhe pllaka zdrukthi | Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer |
| Dysheme magnezi (jo xylolite) | Sikafloor®-02 Primer | |
| <p>1. Nëse trashësia e shtresës së Sikafloor®-300 Rapid Level tejkalon 10 mm lyeni 2 herë nënshtresën e gipsit me prajmerin Sikafloor®-155 WN. Nëse Sikafloor®-155 WN nuk është spërkatur plotësisht me rërë kuarci (0,2-0,8 mm), përdorni Sikafloor®-02 Primer përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Rapid Level.</p> | | |
| Koha e punueshmërisë | ~ 25 min. në +20°C | |

| Veshja | Trashësia e shtresës | Koha e pritjes |
|--|----------------------|----------------|
| Moketë, vinil, linoleum | ≤10 mm | ~1.5-2 orë |
| Veshje të ndjeshme ndaj lagështisë, p.sh. parket, dru tape | ≤10 mm | ~12 orë |
| Dysheme rrëshire | ≤5 mm | ~3 orë |

Të gjitha vlerat jepen me përafërsi dhe janë subjekt i ndryshimeve klimatike. Vlerat jepen në 20°C dhe 65% lagështi relative, temperaturë nënshtrës +15°C.

Kur do të mbuloni Sikafloor®-300 Rapid Level sigurohuni gjithmonë se lagështia e përmbajtur ka rënë në përqindjen e kërkuar nga produkti i mbulimit. Kohët e pritjes përpara mbulimit ndikohen nga trashësia e aplikimit dhe lagështia relative atmosferike. (Referohuni tek skeda teknike e produktit të veshjes).

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Gati për qarkullim këmbësorësh pas ~90 minutash.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtrësia të përshtatshme: betoni, llaçe çimentoje me mpiksje normale dhe të shpejtë, llaçe me bazë gipsi, pllaka qeramike, guri natyror, dysheme magnezi, llaçe mastiku asfaltik (IC10, IC15 sipas EN 13813), pllaka zdrukthi dhe dërrasa të përpunuara të vidhosura.
- Kërkesat e nënshtrësës:
 - Rezistencë e mjaftueshme, kapacitet për mbartje ngarkese, qëndrueshmëri përmasash dhe thatësi e përhershme.
 - Duhet të jetë e qëndrueshme, pastër dhe pa kontaminime, p.sh. pluhur, pislëqë, vaj, graso dhe grimca të lira.
 - Shtresat ndarëse, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë të ngjashëm duhet të hiqen me mjetet e përshtatshme, si smerilizimi, fërkimi me furçë, pastrimi me rrymë abrazive, bluarje ose pastrim i plotë.
 - Shtresat niveluese të vjetra, të lira dhe të dobëta duhet të hiqen mekanikisht.
 - Trajtimet e sipërfaqes apo çdo zonë e shkrifët e nëndyshemesë duhet të hiqen mekanikisht dhe mbushja e vrimave apo hapësirave duhet bërë me Sikafloor®-050 Patch.
 - Shtresat e adezivëve të tretshëm në ujë, p.sh. adezivët me mbetje sulfitesh duhet të hiqen mekanikisht. Mbetjet e adezivëve duhet të lyhen me prajmerin Sikafloor®-155WN/-156/-160/-161 ose Sika® Primer MB Rapid. Nëse ky prajmer nuk është spërkatur plotësisht me rërë kuarci (0.2-0.8 mm), Sikafloor®-02 Primer duhet të përdoret përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Rapid Level.
 - Adezivët e vjetër me rezistencë ndaj ujit duhet të hiqen mekanikisht sa më shumë të jetë e mundur.
 - Shtresat (veshjet) e vjetra, qeramike dhe prej guri natyror duhet të jenë shtruar mirë, të pastruar dhe të smeriluar plotësisht.
 - Llaçet prej mastiku asfaltik të dyshemeve IC10 dhe IC 15 sipas EN 13813. Sikafloor®-300 Rapid Level duhet të kenë trashësi të paktën 1 mm dhe nuk duhet të tejkalojë 3 mm. Mastiku asfaltik duhet të spërkatet plotësisht me rërë kuarci (sipërfaqe e ashpër). Nëse

sipërfaqja është e lëmuar (me spërkatje të pamjaftueshme ose sipërfaqje e vjetër e përdorur) përdorni prajmerin Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer të paholluar përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Rapid Level.

- Përdorni prajmerat akrilikë me 1 përbërës Sikafloor®-01 Primer, Sikafloor®-02 Primer, Sikafloor®-03 Primer për një sipërfaqe pa pore dhe me ndërkapje shumë të mirë. Referohuni tek skeda teknike përkatëse.
- Të mos aplikohet mbi nënshtrësia me lagështi në rritje. Nëse do të ketë lagështi në rritje, duhet të aplikohet një membranë efikase kundër lagështisë në përputhje me standardin përkatës kombëtar.
- Përpara aplikimit konfirmoni se dërrasat apo pllakat e zdrukthit janë të fiksuara mirë dhe nuk lëvizin. Smerilizoni sipërfaqen e dërrasave. Parandaloni rrjedhjen e Sikafloor®-300 Rapid Level brenda fugave, plasaritjeve apo vrimave.
- Duhet të zbatohen kërkesat e standardeve përkatëse në fuqi, udhëzimeve dhe skedave teknike.

PËRZIERJA

Shtoni Sikafloor®-300 Rapid Level në ujë të ftohtë e të pastër brenda një ene të pastër dhe përzieni për ~2 min derisa të arrihet një miks homogjen. Rekomandohet përdorimi i një mikseri me shufër. Pas një kohë të shkurtër maturimi, përzieni sërish. Shënim: Mos përzieni Sikafloor®-300 Rapid Level me çimento apo produkt tjetër me bazë çimentoje. Në rast se do të shtohen agregate, shtimi i tyre brenda miksit duhet bërë pasi të jetë përzierë pluhuri me ujin (pra, në fund të procesit të përzierjes).

APLIKIMI

- Pas përzierjes përhapni Sikafloor®-300 Rapid Level me një mallë krëhër (screed rake) ose niveluar me gjilpërë (pin-leveller). Me përdorimin e niveluesit zakonisht nuk është e nevojshme të korrigjoni defektet e mallës me rulin me gjemba ose të niveloni më shumë se një herë.
- Skajet dhe fugat e lëvizjes duhet të adaptohen në të njëjtin nivel me dyshemenë përfundimtare dhe duhet të mbrohen nga rrjedhja e llaçit brenda fugave ose mbi skajet.
- Punimet e nivelimit duhet të aplikohen në trashësi të

- mjaftueshme dhe rrafshësia e nënshtresës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e prodhuesit të pllakave ose të dyshemeve që do të aplikohen.
- Në rast trashësie të madhe shtrese, duhet të shmangët kontakti me strukturat vertikale duke vendosur në perimetër një shirit izolues.
- Nëse do të aplikohet një shtresë e dytë e përbërësit nivelues, shtresa e parë niveluese duhet të lyhet me prajmerin Sikafloor®-03 Primer ose me Sikafloor®-01 Primer (1:1). Nuk duhet të tejkalohet trashësia maksimale e shtresës në rast aplikimi dy shtresash. Shtresa e dytë nuk duhet të tejkalojë trashësinë e shtresës së parë.
- Duhet të shmangët kontakti me metalin, si tubat me përmbajtje uji (p.sh. izolimi i depërimit të tubave), sepse tubacionet prej çeliku posaçërisht të galvanizuara nuk kanë mbrojtje të mjaftueshme ndaj korrodimit.
- Mbroni shtresat niveluese të trajtuara Sikafloor®-300 Rapid Level nga temperaturat e larta të ambientit, rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe thatësira.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat menjëherë pas përdorimit me ujë. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Duhet të zbatohen rekomandimet e aplikueshme, udhëzimet, standardet europiane, rregulloret dhe Fletët e të Dhënave të Sigurisë, së bashku me rregulloret e njohura arkitekturore dhe inxhinierike.

KUFIZIME

- Llaçet e vjetër prej mastiku asfaltik IC10 dhe IC15 (EN 18813), zakonisht janë të plasaritur ose të thyeshëm. Kjo nënshtresë nuk paraqet rezistencë të mjaftueshme që të mund të bëhet aplikimi i llaçit të çimentos me sforcim të ulët. Në këtë rast, rekomandohet përdorimi i llaçit të vetënivelueshëm me bazë gipsi që nuk ushtron sforcim.
- Aplikoni shtresën e vetënivelueshme të llaçit me trashësi min. 2 mm kur do të mbulohet me parket.
- Aplikoni shtresën e vetënivelueshme të llaçit me trashësi min. 4 mm kur do të mbulohet me sisteme dyshemeje prej rrëshire.
- Kur Sikafloor®-300 Rapid Level do të mbulohet me dysheme rrëshire pa fuga, rekomandohet aplikimi i dyshemesë në trashësi min. 2 mm. Që të sigurohet përgatitja e duhur dhe një sipërfaqe e vazhdueshme pa pore rekomandohet të aplikohen dy veshje prajmeri, që përbëhen nga Sikafloor®-03 Primer me rul dhe një veshje e dytë Sikafloor®-161 + 2% Extender T e aplikuar si një veshje fillestare. Inspektoni veshjen e prajmerit që të siguroheni se nuk ka pore përpara aplikimit të llaçit të vetënivelueshëm ditën e nesërme. Rezistenca e ndërkapjes së kombinimit të dy prajmerave mbi Sikafloor®-300 Rapid Level duhet të jetë ~1.0 N/mm².
- Nënshtresat prej druri në kombinim me veshjen me pllaka qeramike duhet të jenë një sistem jo i ngjitur me përdorimin e një membrane ose shtrese izoluese.

Për më tepër informacione këshillohuni me shërbimin teknik të Sika-s.

- Sipas rregulloreve gjermane, për aplikimin vijues të llaçeve me bazë çimentoje për dyshemetë, përqindja e lagështisë së përmbajtur të tij duhet të jetë ≤ 2.0 CM-% (për llaçet që ngrohen ≤ 1.8 CM-%), dhe llaçeve të gipsit duhet të kenë lagështi të përmbajtur ≤ 0.5 CM-% (për llaçet që ngrohen ≤ 0.3 CM-%).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-300 Rapid Level
Mars 2019, Botimi 03.01
020815030010000154

Sikafloor-300RapidLevel-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf

